



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
ADMINISTRATORI

Nr. 507/12 Prot.

Tiranë, më 10/02 /2025

NJOFTIM
PËR APLIKIM PËR 1(NJË) MJEK TË PËRGJITHSHËM
(angazhim me kontratë shërbimi)

Universiteti i Sporteve të Tiranës, në zbatim të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në kuadër të realizimit të modulit “Ski”, si dhe në shkresën e Dekanit të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes me nr. 507/1 prot., datë 10.02.2025 “Kërkesë për një mjek për Modulin “Ski” me kontratë shërbimi”, për arsye të realizimit të ngarkesës mësimore për modulin “Ski” që do të zhvillohet në Voskopojë, sipas planifikimit të strukturës mësimore për datat 23.02.2025 - 02.03.2025, kërkohet 1(një) mjek i përgjithshëm i angazhuar me kontratë shërbimi për të shoqëruar grupet në zhvillimin e procesit mësimor.

Mjeku duhet të plotësojë këto kritere të përgjithshme:

- 1.Kandidati të zotëroj titullin “Mjek”, të dëshmuar me Diplomë dhe Listë Notash të lëshuar nga Institucionet e Arsimit të Lartë të fushës së mjeksisë.
- 2.Të ketë eksperiencë pune së paku 1(një) vit.

Kandidatët që aplikojnë, duhet të dorëzojnë brenda datës 14.02.2025 në zyrën e Protokollit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, këto dokumenta:

- Kërkesë me shkrim për aplikim;
- Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard (europass);
- Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
- Kopje e noterizuar e diplomës/diplomave dhe njehsimin e tyre në MAS (për diplomat e marra jashtë vendit);
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore, vetëdeklarim sipas formës së kërkuar nga ligji;
- Vetëdeklarim mbi parandalimin e konfliktit të interesit.

Mënyra e vlerësimit: Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurrimit me dosje.

ADMINISTRATORI

Haxhirete Sulaj

